



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:255633

Datë: 25.04.2024

Numri i dokumentit: 05620248

**AC.nr.8632/2021**

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin gjyqësor, në përbërje prej gjyqtarit Besnik Bislimaj kryetar i kolegjit dhe gjyqtarëve Faton Ademi dhe Hidajete Gashi Alaj, anëtarë të kolegjit në çështjen juridiko-civile të paditësit M. A. B. fshati B. i M.- Fushë Kosovë, të cilin e përfaqëson S. B. avokat nga Prishtina, kundër të paditurit Korporata Energjetike e Kosovës sh.a me seli në Prishtinë, Sheshi nëna Terezë nr. 36 , të cilën e përfaqëson J. M. më autorizim, për shkak të kompensimit të diferencës së pagës, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.3191/2016 i datës 21.07.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 22.04.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

APROVOHET e themeltë ankesa e të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës sh.a me seli në Prishtinë, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.3191/2016 i datës 21.07.2021 ashtu që tani gjykohet si në vijim: Refuzohet kërkesë padia e paditësit M. A. B. fshati B. i M.- Fushë Kosovë, përmes së cilës ka kërkuar që: “APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditësit M. A. B. nga Fushë Kosova dhe të detyrohet e paditura Korporata Energjetike e Kosovës sh.a Prishtinë , Sheshi nëna Terezë nr. 36, që paditësit M. A. B. t’ia paguaj diferencën në paga për periudhën 01.10.2016 deri më 21.06.2021 shumën neto :1474.88 euro, kamatën ligjore në shumë prej: 371.40 euro- në total :1846.28Euro. si dhe detyrohet e paditura që t’ia paguaj edhe kontributin për Trustin Pensional 172.50 Euro në emër të paditësit si dhe Tatimin Administratës Tatimore të Kosovës për këtë diferencë të pagave në shumë prej 163.87 euro, të gjitha këto në afat prej 7 ditëve nga pranimi i aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm”, në tërësi si e pa bazuar.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

## A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar, C.nr.3191/2016 i datës 21.07.2021, ka vendosur:

I. APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditësit M. A. B. nga Fushë Kosova dhe DETYROHET e paditura Korporata Energjetike e Kosovës sh.a Prishtinë, Sheshi nëna Terezë nr. 36 , që paditësit M. A. B. t'ia paguaj diferencën në paga për periudhën 01.10.2016 deri më 21.06.2021 shumën neto :1474.88 Euro, kamatën ligjore në shumë prej: 371.40 euro- në total :1846.28Euro.

II. Nga diferenca në paga si në pikën I. të dispozitivit të këtij Aktgjykimi , detyrohet e paditura që t'ia paguaj edhe kontributin për Trustin Pensional ;172.50 Euro në emër të paditësit si dhe Tatimin Administratës Tatimore të Kosovës për këtë diferencë të pagave në shumë prej:163.87 Euro- të gjitha këto në afat prej 7 ditëve nga pranimi i aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

III. DETYROHET pala e paditur që paditësit t'ia kompensoi shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej:544€ .

Kundër këtij aktgjykimi e paditura përmes të autorizuarit të saj, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit që ta aprovoj ankesën e të paditurës dhe ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar ashtu që ta refuzoj në tërësi kërkesë padinë e paditësit si të pa bazuar apo të njëjtin ta prishë dhe lenden ta kthej gjykatës se shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesën e të paditurës ka parashtruar paditësi duke propozuar gjykatës së Apelit që ta refuzoj si të pa bazuar ankesën e të paditurës si dhe të vërteton aktgjykimin e ankimuar.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së gjeti se:

*Ankesa e paditëses është e pa themeltë.*

Nga shkresat e lëndës, rrjedh se paditësi M. B., nga fshati B. i M., Komuna Fushë Kosovë, në Gjykatën e shkallës së parë, me datë 20.12.2016, ka paraqitur padi, kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës sh.a me seli në Prishtinë, për kompensimin e diferencës së pagave, të cilën kërkesë e ka precizuar me parashtrësën e datës 15.07.2021 përmes së cilës ka kërkuar konkretisht si në këtë parashtrësë si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor, dëgjimit të palëve ndërgjyqëse si dhe administrimit të provave, ka marrë aktgjykimin C.nr. 3191/2016 datë 21.07.2021, me të cilin ka aprovuar në tërësi kërkesë padinë e paditëses si të bazuar, duke vendosur konkretisht si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e shkallës së parë, në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar ndër të tjera ka arsyetuar se: Gjykata ka gjetur se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune me të paditurën me kontratë punë nr. 7837 te dt. 01.03.2014, pas lëndimeve që kanë ndodhur në vitin 2004. Paga mujore sipas kontratës së punës ka qenë 496 Euro sipas kësaj kontrate. Me kontratë punë të dt. 01.10.2016, e paditura paditësin e lenë në vendin e njëjtte të punës te e paditura Garderobist por ia zbret pagën mujore prej 30 Euro për çka në këtë rast ka vepruar në kundërshtim me ligjin e punës, nenin 17, par.1 dhe 2 të ligjit dhe në kundërshtim me nenin 19 të Kodit të punës te të paditurës si dhe të kontratës të mëparshme të punës.

Më tej ka arsyetuar se: Lartasin e kërkesëpadisë gjykata e ka bazuar në ekspertizën financiare të dt. 21.06.20201, e cila nuk është kundërshtuar nga e paditura dhe nuk ka pas propozim eventual për ekspertizë tjetër.

Më tej ka arsyetuar se: Gjykata pati për bazë edhe kundërshtimet që i ka parashtruar pala e paditur përmes përgjegjës në padi dhe deklarimeve të përfaqësuesit të të paditurës në seancën e shqyrtimit kryesor, por ato i konsideroj si të pabazuara, andaj gjykata vendosi për këtë çështje konform provave në shkresat e lendes të pranuar nga të dyja palët ndërgjyqëse, duke e aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses.

Lidhur me kamatën gjykata e shkallës së parë ka vendosur në kuptim të nenit 382 të LMD-së

Lidhur me shpenzimet e procedurës është vendosur në kuptim të nenit 449 dhe 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson së përkundër faktit që aktvendimi i ankimuar rezulton të mos jetë i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe as me Shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të pretenduara me ankesën nga ana e të paditurës. Mirëpo gjykata e Apelit gjen se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës shkallës së parë rreth mënyrës së vendosjes është marre me zbatim të gabuar të drejtës materiale, për shkak se sipas vlerësimit të kësaj gjykate gjendja faktike e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë nuk korrespondon drejtë me provat nga shkresat lëndore, ku për pasojë më rastin e vendosjes sipas aktgjykimit të ankimuar ka ardhur gjer tek zbatimi i gabuar i të drejtës materiale. Gjykata ankimore me anë të vlerësimit ndryshe të shkresave dhe provave të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit kryesor nga gjykata e shkallës së parë konstaton një gjendje faktike tjetër nga ajo e cila është konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, mbi bazën e së cilës gjendje faktike kjo gjykatë vjen në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar dhe si e tillë duhet refuzuar, me çka në rastin konkret ka gjetur se ka kushte që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, ku edhe ka vendos si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

Gjykata e Apelit gjen se paditësja me padi ka kërkuar kompensimin e diferencës së pagës sipas kontratës së punës së datës 01.03.2014. Gjykata e Apelit duke vlerësuar provat që gjinden në shkresat e lëndës, por edhe theksimet e palëve ndërgjyqëse ka konstatuar se nuk është kontestuese në mes palëve se paditësi me kontratën e punës me nr. 7837/0 të datës 01.03.2014, palët kontraktuese janë marrë vesh me të gjitha të drejtat dhe detyrime që dalin nga kjo kontratë, në të cilën është përcaktuar edhe lartësia e pagës mujore prej 496.00 euro. Gjithashtu nuk është kontestuese që paditësi me të paditurën kanë lidhur kontratë pune me nr. 7837/0 të datës 01.10.2016, palët kontraktuese janë marrë vesh me të gjitha të drejtat dhe detyrime që dalin nga kjo kontratë, në të cilën është përcaktuar edhe lartësia e pagës mujore prej 466.00 euro të cilën kontratë e ka nënshkruar edhe paditësi pa ndonjë vërejtje, fakte këto të vërtetuara nga kontratat e punës së cekura si më lartë. Andaj, duke qenë se paditësi me të paditurën kanë lidhur kontratë pune të re me 01.10.2016, në të cilën është përcaktuar edhe lartësia e të ardhurave personale, e paditura me të drejtë ka vazhduar të paguaj pagën mujore në bazë të kësaj kontrate, pasi që kontrata e vitit 2014 tani më nuk është valide pasi që me nënshkrimin e kontratës së re, e njëjta kontratë nuk prodhon efekt juridik dhe si e tillë nuk mund të zbatohet.

Sipas nenit 10 të Ligjit të Punës (Ligji NR.03/L-2012) i cili parasheh që “kontrata e punës lidhen në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga punëdhënësi dhe i punësuarit, kontrata përfshinë elementet e përcaktuara sipas nenit 11 të këtij ligji” Me nenin 11 par. 1 të po të njëjtit ligj i cili në pikën 1.8 parasheh që: “kontrata e punës përmban në mes tjerash lartësinë e pagës bazë si dhe ndonjë shtesë ose të ardhur tjetër.”. sipas nenit 17 par 1 i po të njëjtit ligj, i cili parasheh që “i Punësuarit caktohet në vendin e punës, për të cilin ka lidhur kontratë pune”, ndërsa në paragrafin 3 i po të njëjtit nen, i cili parasheh që “i punësuarit sipas nevojës mund të sistemohet në punë nga një vend në një vend tjetër, tek i njëjti punëdhënësi në pajtim me Kontratën e Punës, aktin e brendshëm të punëdhënësit dhe kontratën kolektive” sipas nenit 55 par. 1 i po të njëjtit ligj, i cili parasheh që “I punësuarit ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me kontratën e punës, në pajtim me këtë ligj, kontratën kolektive, aktin e brendshëm të punëdhënësit”. Andaj, në rastin konkret paditësja nuk ka ofruar asnjë provë për të vërtetuar faktin e kundërligjshmërisë së veprimeve të të paditurës me rastin e lidhjes së kontratës së re me nr. 7837/0 të datës 01.10.2016, me të cilën kontratë është caktuar lartësia e pagës mujore e paditësit, pasi që kontrata e cekur si më lartë është lidhur me vullnetin e dy palëve e që një fakt i tillë konfirmohet me nënshkrimin nga ana e palëve kontraktuese.

Andaj, duke u nisur nga kjo gjendje faktike e vërtetuar, gjykatës së Apelit i rezulton si e pa bazuar kërkesë padisë e paditësi dhe të njëjtën e refuzon në tërësi si të pa bazuar pasi që paditësi nuk ka ofruar prova për të vërtetuar të drejtën e tij në lidhje me kompensimin e diferencës së pagës dhe sipas nenit 7.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) ku është paraparë se “palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”. E që në rastin konkret paditësi ka dështuar të paraqes prova për vërtetimin e faktit se i njëjti ka qenë e detyruar të nënshkruaj kontratën e punës në vitin 2016. Fakti që paditësi ka ushtruar kundërshtim në lidhje me kontratën e nënshkruar si dhe lartësinë e pagës, pretendim të tillë gjykata e Apelit nuk e mori për bazë pasi që me këtë kundërshtim nuk mund të vërtetohet fakti se paditësi e ka kundërshtuar lidhjen e kontratës në momentin e nënshkrimit të sajë dhe i cili në atë moment ka mundur që fare mos të lidhë kontratë të re pasi

që i njëjti kishte kontratë me të paditurën që nga data 01.03.2014 me lartësi të pagës prej 496.00 euro, por me nënshkrimin e kontratës së re me nr. 7837/0 të datës 01.10.2016 , i njëjti jep pëlqimin edhe për lartësinë e pagës së re të përcaktuar nga kjo kontratë dhe në këtë raste paditësit i mungon baza juridike për të kërkuar një kërkesë të tillë të kompensimit të diferencës së pagës.

Gjykata e Apelit nuk e morri për bazë ekspertizën e ekspertit financiar, pasi që në këtë çështje paditëses i mungon baza juridike e kërkesë padisë dhe vlerësimi i ekspertizës është i pa nevojshëm dhe irelevante për këtë çështje kontestimore.

Gjykata e Apelit vlerëson se edhe për kundër faktit që ka refuzuar kërkesë padinë e paditësit, i vlerësoj pretendimet e të paditurës në lidhje afatin e parashtrimit të padisë si dhe mos shtjerrjen e mjeteve të brendshme në kuptim të nenit 78 të Ligjit të Punës, por të njëjtat pretendime nuk i morri për bazë pasi që të njëjtat janë të pa bazuar për faktin se nisur nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësi me datë 25.11.2016 ka ushtruar kundërshtim pranë të paditurës në lidhje me këtë çështje për të cilën e paditura nuk ka marrë kurrfarë vendimi dhe padinë në gjykatë e ka parashtruar me datë 20.12.2016. dhe si e tillë e njëjta është ushtruar në afatin e paraparë ligjorë. Por meqenëse se të njëjtës i mungon baza juridike, Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi që secila palë ti bartë shpenzimet e veta procedurale pasi që e paditura nuk i ka kërkuar. Andaj, vendosi në kuptim të nenit 450 të LPK-së.

Nga të cekurat u vendos sikurse në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën e) e lidhur me nenin 201 par.1 nën pikën b) të LPK.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.8632/2021, datë 22.04.2024**

Kryetari i kolegjit, Gjyqtari  
Besnik Bislímaj, d.v